

VENDIM
Nr.922, datë 21.12.2011

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 21 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, më poshtë e quajtur DPPP, si institucion qendror buxhetor, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Financave.

2. DPPP-ja është njësi e inteligjencës financiare shqiptare dhe funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe autoritetet e tjera kompetente të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. DPPP-ja përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

4. DPPP-ja bashkëpunon me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet përkatëse, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të zbatimit të standardeve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për harmonizimin e legjislacionit me këto standarde.

5. Drejtori i Përgjithshëm, në zbatim të detyrave të ngarkuara me ligj, ushtron këto përgjegjësi:

a) Drejton DPPP-në dhe e përfaqëson atë brenda dhe jashtë vendit.

b) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me njësi homologe të inteligjencës financiare në zbatim të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

c) Organizon punën për hartimin e raportit vjetor, brenda afatit ligjor, si dhe vendos publikimin e tij në gjuhën shqipe dhe angleze.

ç) U raporton me shkrim Ministrit të Financave dhe Kryeministrit, sa herë që i kërkohet, por jo më pak se 2 (dy) herë në vit, për veprimtarinë e DPPP-së dhe problematikat që kanë të bëjnë me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

d) Raporton sa herë që kërkohet në komisionet parlamentare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë e DPPP-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

dh) Drejton dhe orienton punën e grupit teknik ndërinstitucional në kuadrin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave.

e) Me miratimin e Ministrit të Financave, emëron zëvendës drejtorët e përgjithshëm, të cilët janë edhe drejtorë të drejtorive përkatëse.

ë) Emëron, shkarkon dhe liron nga shërbimi në DPPP punonjësit e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

f) Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, nxjerr urdhra, udhëzime e detyra në nivel drejtorie apo për strukturat brenda saj, si dhe organizon ushtrimin e kontrollit për zbatimin e tyre.

g) Merr vendime administrative për rastet e shkeljeve të konstatuara nga Drejtoria e Inspektimit dhe Legjislacionit.

6. DPPP-ja është institucion qendror buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit. Të ardhurat e siguruar nga vjelja e gjobave derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

7. Vendimi nr.108, datë 11.2.2005 i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”, të ndryshuar, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të

Parandalimit të Pastrimit të Parave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha